



Në bazë të nenit 55 paragrafi (1) të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/ 11 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 96/19, 110/19, 154/19 dhe 121/2024), dhe në lidhje me nenin 8 paragrafi (5) të Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 61/04, 96/04, 67/07, 156/09, 47/11, 192/15, 209/18 dhe "Gazeta zyrtare e RMV" nr. 244/19, 53/21, 77/21, 150/21, 173/22 dhe 170/2024) dhe nenit 46-b të Ligjit për ekzekutimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 283/23 dhe 169 /2024), Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nxori

Kriteret dhe procedurat për shpërndarjen e granteve kapitale për projekte infrastrukturore nëpër komuna në fushën e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor për vitin 2024

Në Buxhetin e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, për vitin 2024 në seksionin 18010 - Financimi i veprimtarive në fushën e mjedisit Jetësor dhe planifikimit hapësinor, në Programin/Nënprogramin A - Decentralizimi, AA Projektet e infrastrukturës në komuna, kategoria 48 - shpenzimet kapitale, në zërin 488 - grante kapitale për NJVL-të, si shtesë me ndryshimet dhe plotësimet në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 169/2024) parashikohen mjete për këtë qëllim.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor do t'i shpërndajë këto grante kapitale për projekte infrastrukturore nëpër komuna për vitin 2024 në pajtim me Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe Ligjin për zbatimin e buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024.

I. KRITERET

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor do të shpërndajë grantet kapitale për projektet infrastrukturore nëpër komuna në fushën e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor sipas kriterëve në vijim:

- shpërndarja e mjeteve financiare të siguruara për kokë banori të popullatës rezidente në secilën komunë sipas regjistrimit të fundit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe
- Dokumentacionin e plotë të nevojshëm të projektit me të gjitha lejet dhe pëlqimet e nevojshme, me një përlllogaritje paraprake të rishikuar jo më të vjetër se 12 muaj.

II. PROCEDURAT

Në pajtim me nenin 8 paragrafi (1) të Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 61/04, 96/04, 67/07, 156/09, 47/ 11, 192/ 15, 209/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 244/19, 53/21, 77/21, 150/21, 173/22 dhe 170/2024), me subvencione nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nga buxhetet e mjeteve, sigurohen



mjetet me të hyra shtesë në buxhetin e komunës për financimin e kompetencave të saj të përcaktuara me ligj.

Në pajtim me nenin 8 paragrafi (3) të këtij ligji, lloji, shuma dhe shpërndarja e subvencioneve sipas komunave janë pjesë përbërëse e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe buxheteve të mjeteve.

Në pajtim me nenin 11 paragrafi (5) të këtij ligji, në rast të sigurimit të mjeteve shtesë me ndryshimet dhe plotësimet në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ministritë dhe fondet kompetente në afat prej një muaji nga data e hyrjes në fuqi të të njëjtës do të publikojë kriteret, procedurat dhe afatet e përcaktuara për shpërndarjen e granteve kapitale.

Në pajtim me nenin 11 paragrafi (6) të të njëjtit ligj, granti kapital përdoret në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor do të publikojë në ueb faqen e saj kriteret dhe procedurat për ndarjen e granteve kapitale për projektet infrastrukturore në komunat në fushën e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor për vitin 2024.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale, do të themelojë një trup koordinues ndërsektorial për monitorimin dhe koordinimin e aktiviteteve për realizimin e Programit AA – Projektet e infrastrukturës së komunave. Ministria e Vetëqeverisjes Lokale do të publikojë thirrje për shprehje interesi nga komunat për financimin e projekteve infrastrukturore në bazë të kriterëve të publikuara në këtë njoftim.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 11 paragrafi (6) të Ligjit për financimin e njërive të vetëqeverisjes lokale dhe në pajtim me nenin 46-b të Ligjit për ekzekutimin e buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024, me propozim të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale do të nxjerr Vendim për shfrytëzimin e granteve kapitale për projekte infrastrukturore për komunat për vitin 2024.

Pas miratimit të Vendimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor do të japë kontrata me të cilat do të rregullohen të drejtat dhe obligimet e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe njësisë së vetëqeverisjes lokale përfutuese e fondeve kapitale për projekte infrastrukturore për vitin 2024.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor do të monitorojë përdorimin e grantit kapital dhe në pajtim me nenin 46-b të Ligjit për ekzekutimin e buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024, pagesa e mjeteve do të bëhet në bazë të punimeve të kryera dhe dokumentacionit të plotë të pagesës .

Me rastin e konstatimit të parregullsive në shfrytëzimin e granteve, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor mund të ndalojë pagesën e mjeteve dhe për këtë do ta njoftojë Ministrinë e Financave.

III. MËNYRA E SHPËRNDARJES

Komisioni vlerësues do të bëjë verifikimin e plotësisë dhe vlefshmërisë, përzgjedhjen dhe do të dorëzojë propozimin për përzgjedhjen e projekteve për financim te ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.



Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor do t'i dorëzojë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut propozim Vendim për shfrytëzimin e granteve kapitale për projekte infrastrukturore për komunat për vitin 2024.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor do t'i ndajë kontratat për subvencione kapitale në fushën e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor për vitin 2024 menjëherë pas miratimit të Vendimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor